

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Have Haliti dhe Driton Muharremi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.A. nga Prishtina, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. A.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.182/2017 të dt. 08.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 të KPPK, me datë 15.08.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin ankesës së mbrojtësit të akuzuarit F.A., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.182/2017 i dt. 08.06.2017, vetëm përkitazi me vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin F.A., për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, 10 (dhjet) muaj, kurse për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e merr si të vërtetuar, konform nenit 80 të KPRK e dënon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 14.04.2017, e tutje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.182/2017 të datë 08.06.2017, i akuzuari F.A. është shpall fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, konformë nenit 80 të KPRK-së, është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.04.2017, e tutje. Nga i akuzuari është konfiskuar revolva e markës së panjohur, e kalibrit 7.65 mm, si mjet i kryerjes së veprës penale. I akuzuari është obliguar që të paguaj në

emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 euro, brenda afatit prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F.A., për realizimin e kërkesës pasurore- juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësi i të akuzuarit F.A. av. A.H., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.360/2017 të dt. 01.08.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.A., av. A.H. të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, në të cilën prezantuan, i akuzuari, mbrojtësi i të akuzuarit av. A.H., kurse nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari F.A., të cilët ishin njoftuar me rregull për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se :

Ankesa mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e aktgjykimit, se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, sepse me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimor përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon, se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i lartë, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka bërë zbutjen e dënimit në kontekst të dëmit unik, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është i moshës relativisht të re dhe në shtëpi ka vetëm nënën e tij, e cila është e sëmur dhe është shfrytëzuese e ndihmës sociale, se i dëmtuari nuk ka pësuar lëndime, nuk është goditur në atë rast, duke i pasur parasysh

këto rrethana ka vend që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i ulët, më të cilin mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kështu që të akuzuarit F.A., si rrethanë lehtësuese i ka marrë pranimin e fajësisë, kurse si rrethanë rëndues ka marrë për bazë, se ndaj të akuzuarit janë në zhvillim edhe dy procedura tjera penale, të cilat kanë ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim kuadër të minimumit të paraparë me ligjë.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas pretendimeve ankimore të paraqitura nga ana e mbrojtësit të akuzuarit dhe sipas deyrës zyrtare konstaton se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit nga neni 385 par.1 pika 1.5 të KPPK-së, kjo për arsye se a gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit tejkalon kompetencat e saja ligjore dhe të akuzuarit për dy veprat penale, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje 3 vjet e 6 muaj, e duke mos respektuar dispoziten e nenit 80 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, mbi shqitimin e dënimit unik. Gjykata e Apelit të akuzuarit për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i përcakton dënim me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, 10 (dhjet) muaj, kurse për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e merr si të vërtetuar dhe për dy veprat penale i shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, e më këtë e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe evitoj shkeljen e ligjit penal.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë i merr si të vërtetuara, përveq rrethanës që ka të bëjë me denuashmërin e të akuzuarit të cilin gjykata e shkallës së parë e ka marrë si rrethanë rënduese, e cila nuk qendron se nuk kemi aktgjykim të formes së prerë. Në prezencën e rrethanave lehtësuese, se i akuzuari është person i moshës relativisht të re, se është i gjendjes së varfër ekonomiki, ka pranuar fajësin, gjë që nënkupton pendimin e tij, si dhe rrethanën se të dëmtuarit nuk i janë shkaktuar pasoja të dëmshme për jetën dhe trupin e tij. Gjykata e Apelit e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me vendimin mbi dënimin për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe i përcaktoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 10 (dhjet) muaj, ndërsa për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e merr si të vërtetuar dhe për të dy veprat penale ja shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, i cili dënim i përgjigjet peshës së veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit dhe është në përpjesëtim të plot me veprimet e ndërmarra nga i akuzuari, e me bindje se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 403 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.372/17, me datë 15.08.2017

Procesmbajtësi

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit

1. Have Haliti

2.Driton Muharremi

Kryetari i kolegjit

Xhevdet Abazi,